



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01 Nr. 104/02-4209/22

Kaçanik, 28.02.2022

Në bazë të nenin 5 pika 2 e Ligjit Nr. 03L-/087 të Ndërmarrjeve Publike, të nenin (Gazeta Zyrtare Nr. 31/15 Qershor 2008) si dhe Ligjeve për ndryshim plotësimin e këtij ligji, Ligji Nr. 04/L- 111 dhe Ligji Nr. 05/L -009 të vitit 2015, të nenit 5, 12 pika 2(d) lidhur me nenin 17(f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës(bashkëngjitur), Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me datë 28 Shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARVE PËR NPK
"STACIONI I AUTOBUSVE " SH.A- KAÇANIK

1. Me këtë Vendim formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale (NPK) "Stacioni i Autobusëve" Sh. A- Kaçanik.

2. Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale "Stacioni i Autobusëve", SH.A- Kaçanik, në përputhje me ligjet në fuqi do të ketë 3 anëtarë: 1 (Një) anëtar emërohet nga Kryetari i Komunës dhe 2 (dy) anëtarë emërohen nga Kuvendi i Komunës, në përbërje si vijon:

2.1 Rustem Zenuni	anëtar	nga subjekti politik i PDK,
2.2 Ernesta Krasniqi	anëtar	nga subjekti politik i LVV,
2.3 Murat Burrniku	anëtar	nga Ekzekutivi i Komunës.

3. Detyrat e Komisionit Komunal të Aksionarëve janë të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike si dhe në Ligjin për Shoqëritë Tregtare si dhe Ndryshim Plotësimet e këtyre ligjeve dy ligjeve.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.

6. Me këtë vendim njoftohen: Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante) dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E EKONOMISE
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY

Nr. Dokumenti: 0713
Nr. Protokol: 2
Nr. Flet: 531
Data: 15.03.22

HYRESE - ULAZNA - INCOMING
REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit te Pusstetit Lokal
Ministartshivo Lokale / Subministrtshivo i Administratshive
Ministry of Local Government Administration

Data: 15.03.2022

Nr. Dokumenti: 010-223/5

DATA	14.03.2022
PËR/ZA/TO:	Z. Besim Ilazi, Kryetari i Komunës Kaçanikut
CC:	Znj. Venera Çerkini, zv. Sekretare e Përgjithshme/MAPL Z. Besim Myrtezani, zv. udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave/MAPL Znj. Leonita Shabani, zv. Sekretare e Përgjithshme/ME Z. Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Z. Gëzim Sahiti, zyrtar i lartë për Monitorim të Komunave /MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Besim Imeri, Udhëheqës i NJPMNP-së
NGA/OD/FROM:	Arbërore Bernica-Hasani, analiste/NJPMNP
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vlerësimi i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Kaçanikut

I nderuar,

Në pajtim me Rregullore (qrk) nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (qrk) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë së Ekonomisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregullore (QRK) - Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive. Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike /NJPMNP/Ministria e Ekonomisë/ME, ka pranuar për shqyrtim aktin komunal në vijim:

Vendimin e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut i miratuar me datë 31.01.2022, i pranuar në NJPMNP/ME nga MAPL me dt.09.03.2022 për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A Kaçanik, i miratuar nga Kuvendi dhe nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Mbështetur në ligjin nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike neni 5 paragrafi 2 rregullon "Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohet nga një Komision Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet, me

shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar "

Ministria e Ekonomisë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës si i tillë është në harmoni me legjislacionin aktual për ndërmarrje publike dhe mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Ekonomisë, mbetet në dispozicion të Komunës dhe MAPL-së për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Respekt!